



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 40, Datë 29.03.2024**

**MBI**

**MIRATIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE TË ERE PËR PERIUDHEËN 2024 –  
2026**

Në mbështetje të neneve 10, 16, 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 3 gërmës “d” të Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 199, datë 27.11.2020; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 829/2 prot, datë 27.03.2024 “Për miratimin e objektivave strategjike të ERE-s për periudhën 2024-2026”,

**Konstatoi se:**

- Referuar ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4, përcaktohet se Ministria përgjegjëse për energjinë: *Harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë.*
- Në zbatim të ligjit nr. 43/2015, ERE harton dhe miraton objektivat e saj strategjike për kryerjen e funksioneve rregullatore të përcaktuara në nenin 18 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 74, datë 12.03.2021 ka miratuar objektivat strategjike për periudhën 2021-2023, pas miratimit, ndjekjes së realizimit të tyre dhe miratimit të progres raportit në zbatim të objektivave strategjike të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 74/2021, ERE ka paraqitur objektiva të reja të veprimtarisë së saj për periudhën vijuese 2024-2026.
- Objektivat strategjike të ERE-s për periudhën 2024 - 2026 përfshijnë:
  - Mbrojtjen e konsumatorëve duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në tregjet e energjisë;

- Rregullimi efektiv për një treg konkurrues përmes monitorimit dhe raportimit, tarifave të drejta, zbatimit dhe përputhshmërisë;
- Promovimi i rregullimit efikas të infrastrukturës duke inkurajuar operatorët e rrjeteve për të shërbyer si platforma ndëraktive për shërbimet energjitike;
- Përdorimi i ekspertizës tonë për të informuar rreth zhvillimeve të tregut energjisë dhe mbështetja e ERE-s gjatë periudhës së tranzicionit të hapjes së tregut të energjisë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë Objektivat Strategjike të ERE-s për periudhën 2024 – 2026. (Bashkëlidhur)
2. Ngarkohen Strukturat e ERE-s të raportojnë çdo 4 muaj mbi ecurinë e objektivave të miratuara sipas këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për koordinimin dhe ndjekjen e ecurisë së zbatimit të detyrave sipas këtyre objektivave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**

## **OBJEKTIVAT STRATËGJIKË TË ERE PËR PERIUDHËN 2024-2026**

Përmes miratimit të këtyre objektivave ERE siguron vullnetin e plotë të saj për të kontribuar plotësisht në ofrimin e shërbimeve rregullatore në përputhje me politikën në vend, siç është adresimi i çështjeve mjedisore, sigurimi i furnizimit të pandërprerë dhe me cilësi të energjisë dhe mbrojtja e interesave të të gjithë konsumatorëve përfshirë fuqizimi i tyre. Ky plan është rezultat i një procesi të gjerë të studimit të ndryshimeve që ka pësuar tregu i energjisë, politikave rregullatore jo vetëm në eksperiencën e ERE por edhe në kuadër të bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare ku jemi anetarë.

Në praktikën e saj të punës ERE do të vijojë angazhimin me çdo palç të interesit në formën e konsultimeve të saj apo marrjen e opinioneve për përmirësimin e punës së saj apo në hartimin dhe rishikimin e akteve rregullatore.

### **Kapitulli I**

#### **1- Këndveshtrim i përgjithshëm, Misioni, Vizioni dhe objektivat e ERE**

##### **1.1 Krijimi i ERE**

##### **1.2**

Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është rregullatori i pavarur i energjisë elektrike dhe gazit natyror në Shqipëri i krijuar për herë të parë në vitin 1996 me ligjin për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike dhe aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

##### **1.2 Kompetencat:**

ERE është një organ i administratës publike i organizuar si ent public, fusha e përgjegjësisë së të cilit përfshin kompetenca në drejtim të:

##### **Hartimi i akteve rregullatore**

ERE miraton aktet rregullatore në tregun e energjisë lidhur me ushtrimin e aktivitetit të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë, përfshirë kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara.

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Trajton mosmarrëveshjet në lidhje me ankesat e klientëve ndaj të licensuarve dhe ndërmjet të licensuarve.

##### **Shqyrtimi i planeve të investimeve**

Shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët, planet e investimeve të operatorëve të rregulluar.

##### **Licencimi i subjekteve në tregun e energjisë**

Trajton kërkesat për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave për ushtrimin e aktiviteteve në veprimtarinë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike. Në sektorin e gazit natyror, ERE shqyrton aplikimet për licensim për ushtrimin e aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, tregtimit, dhe furnizimit të energjisë.

##### **Përcaktimi i Tarifave**

Aktivitetet që lidhen me detyrimet e shërbimit publik nga të licensuarit realizohen me tarifa dhe çmime të përcaktuara nga ERE.

Rritja e kërkesës për energji, nevoja për zgjerimin e rrjetit apo mirëmbajtje, zhvillimi teknologjik ndikon në kostot e shërbimit, dhe si të tillë në cmimin e shitjes së energjisë elektrike.

### **Monitorimi**

Ligji përcakton të drejtën e ERE për të monitoruar dhe kontrolluar funksionimin e tregut të energjisë elektrike si dhe për të detyruar të licensuarit të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut. Po ashtu ERE monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licensuarve duke ushtruar të drejtën e aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licensuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë si dhe kontrollon nëse shërbimi është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE. Në çdo rast monitoron kryerjen e veprimtarisë nga operatorët e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

### **Organizimi**

ERE është një person juridik publik, me seli në Tiranë dhe përbëhet nga Bordi i Komisionereve me një Kryetar dhe 4 antarë, të cilët kanë funksion vendimmarrës dhe emerohen nga Kuvendi i Shqipërisë. Përveç Bordit është edhe personeli teknik i organizuar në Drejtori dhe Sektore. Pjesë integrale e Strukturës aktuale të ERE janë edhe Keshilltari dhe Sekretari i Përgjithshëm.

#### **Misioni i Entit Rregullator në Sektorin e Energjisë është:**

Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, i cili vendos rregullat lidhur me:

- a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
- b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
- c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
- ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
- d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë europian të energjisë elektrike.

#### **Misioni i Entit Rregullator në Sektorin e Gazit Natyror është:**

Garantimi i shërbimeve për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të sigurt për funksionimin e tregut të gazit natyror, duke mundësuar krijimin e një tregu funksional dhe konkurrues duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me gaz natyror si dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, depozitimit të gazit natyror, si dhe operimit në impiantet e GNL-së, i cili vendos rregullat lidhur me:

- a) përcaktimin e fazave të hapjes së tregut, organizimin dhe funksionimin e nje tregu konkurrues, duke mundësuar dhe siguruar qëndrueshmërinë në investimet e nevojshme në rrjete.
- b) dhënien e autorizimeve dhe licencave për shoqëritë e gazit natyror.
- c) krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të gazit natyror, duke bashkëpunuar me autoritete të tjera rajonale dhe/ose europiane rregullatore.

## **Vizioni ynë**

Një rregullator që njeh rolet dhe përgjegjësitë e tij në sektorin e nergjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilin e ushtron bazuar në parimet e transparencës, besueshmërisë, drejtësisë dhe praktikat më të mira, duke bërë të mundur një sektor konkurrues të energjisë ku çdo palë ndihet e mbrojtur dhe e përfshirë dhe gjithashtu investitori dhe shteti gjejnë të ekuilibruara interesat e tyre.

Puna e ERE në ushtrimin e përgjegjësive të saj rregullatore ndikon jo vetëm ndaj konsumatorëve por edhe aktorëve të tjerë të tilla si operatorët e rrjetit, investitorët, dhe qeveria në kuadër të ofrimit të një shërbimi të sigurt, dhe të qëndrueshëm në interes të të gjitha palëve. ERE vepron si një organ i pavarur por gjithmonë brenda një kuadri politik dhe të vendosur në ligje dhe në aktet e KM apo politikat e tjera të organeve të ngarkuara me ligj për rregullimin e aspekteve të caktuara të sektorit të energjisë.

Një fushë thelbësore e punës sonë për tre vitet e ardhshme është, bashkepunimi me palët e interesuara, duke vendosur një program veprimesh që nevojitet për të arritur objektivat tona 2024- 2026, duke vazhduar të përmbushim kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe ndryshimeve respektive të tij, objekt i fushës së përgjgjësie së ERE. Legjislacioni dhe politika e re në sketorin e energjisë elektrike rrit ndjeshëm rolin dhe përgjegjësinë e ERE në këtë periudhë, pasi merr në konsideratë zhvillimet teknologjike, të sigurisë, përfshirë asaj kibernetike, dhe fuqizimit të konsumatorit referuar Clean Energy Package. Plani ynë strategjik gjithashtu përcakton prioritetet tona për të mundësuar dhe mbrojtur konsumatorët e energjisë, veçanërisht konsumatorët vulnerabël. Sigurimi që klientët aktiv dhe komunitetet e energjisë luajnë një rol në rritje në veprimet në kaudër të mbrojtjes mjedisore zhvillimit të burimeve të rinovueshme, do të jenë fusha thelbësore të fokusit të këtij plani strategjik që bazohet në legjislacion dhe zhvillimet e politikave në vend. Qellimi i këtij plani strategjik është edhe përdorimi eficient i burimeve ekonomike dhe njerezore duke u përshtatur edhe me mënyrat më fleksibile të punës bazuar në një vizion për furnizime të sigurta, dhe të qëndrueshme të energjisë.

Plani ynë strategjik ka tre pjesë: Misioni ynë: - Është ajo që bëjmë çdo ditë bazuar në rolin dhe fushën e përgjgjësie të përcaktuar në ligj;

Vizioni ynë - përcakton një rrugë të qartë për të gjitha shërbimet që ofrojmë.

Objektivat/ prioritetet tona përfshirë planin e veprimeve të ndërlidhura mes tyre pasqyrojnë fushat e fokusit dhe përmirësimin ndër-organizativ për të siguruar në kohë dhe me efikasitet funksionet rregullatore në përputhje me misionin dhe vizionin tonë.

## **Kapitulli II**

### **Objektivat, prioritetet dhe iniciativat**

Roli i ERE në sektorin e energjise elektrike dhe gazit natyror është të sigurojë përmes akteve rregullatore furnizimin e vazhdueshëm, me cilesi dhe me kostot më të ulëta, të promovojë konkurrencën dhe zhvillimin në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe me gaz natyror. ERE përcakton tarifat e operatoreve të rrjetit, monitorimin dhe mbikqyrjen e aktiviteteve të të licencuarve, miratimin e akteve nënligjore për ushtrimin e aktiviteteve në tregun e energjisë.

Në ushtrimin e përgjegjësisë së saj ERE synon të jetë:

- Një institucion i besueshëm, që siguron ekspertizën e saj në shërbimet që ofron;
- Administrim eficient dhe efektiv të proceseve rregullatore.
- Përfshirje të të gjitha palëve të interesit në praktikat rregullatore.

### **Objektivat strategjik të ERE për periudhën 2024- 2026 përfshijnë:**

- Mbrojtjen e konsumatorëve duke u mundësuar atyre të marrin pjesë në tregjet e energjisë;
- Rregullimi efektiv për një treg konkurrues përmes monitorimit dhe raportimit, tarifave të drejta, zbatimit dhe përputhshmërisë.
- Promovimi i rregullimit efikas të infrastrukturës duke inkurajuar operatorët e rrjeteve për të shërbyer si platforma ndëraktive për shërbimet energjitike,
- Përdorimi i ekspertizës tonë për të informuar rreth zhvillimeve të tregut energjisë dhe mbështetja e tranzicionit të energjisë.

Çdo vit, ERE raporton në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kuvend dhe është objekt i vlerësimit dhe rekomandimeve në Rezolutën respektive. Për këtë ERE harton një plan veprimi dhe përshtat planin e veprimit të miratuar në kuadër të Objektivave Strategjike.

Pjesë e vazhdueshme e punës së ERE do të jetë në vijim edhe bashkëpunimi me organet e tjera dhe palët e interesit në tregun e energjisë në fushat me interes të përbashkët, për një konsumator të kënaqur, një sistem i sigurt i energjisë elektrike dhe gazit; zhvillimi efektiv i tregjeve të hapura dhe konkurruese; dhe investime efikase dhe në sistem.

Si rregullator, ne e bëjmë këtë duke kryer funksionet tona rregullatore, në bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët e tjerë për të ndërtuar besimin në autoritetin e ERE. Strategjia jonë është e fokusuar në arritjen e një sistemi të energjisë elektrike që është:

**I qëndrueshëm** - ku konsumatorët mund të kenë mundësi për tu përfshirë në prodhimin, rezervimin dhe në tërësi të përfitojnë nga teknologjitë e rinovueshme.

Ata mund të kontrollojnë përdorimin e tyre të energjisë, duke ulur kostot dhe të ndikojnë përmirësimin e mjedisit.

**Të aksesueshme** - Konsumatorët kanë mundësi përmes proceseve të thjeshta dhe të qëndrueshme për të hyrë në tregun e energjise. Ata mund të zgjedhin furnizuesit e tyre të energjisë nga një treg konkurrues dhe efikas.

**Siguri dhe efikasitet** - Konsumatorët kanë besim në furnizuesit e tyre të energjisë dhe janë me pak të ekspozuar ndaj çmimeve të larta.

Objektivi kryesor i ERE është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, tani dhe në të ardhmen, duke përfshirë interesin e tyre në një mjedis më të pastër dhe më të gjelbër. Në synojme ta arrijmë këtë duke vendosur:

- çmime të drejta për konsumatorët
- monitorimin dhe zbatimin e standardeve të cilësisë dhe standardeve të shërbimit

ERE synon të jetë fleksibile për të përshtatur shërbimet dhe praktikat rregullatore zhvillimet dhe sfidat e reja të sektorit të energjisë.

### KAPITULLI 3

#### Objektivi 1 - Mbrojtja e konsumatorëve në nevojë dhe fuqizimi i konsumatorëve

Një nga prioritetet kryesore të punës së ERE është mbrojtja e konsumatorëve me fokus në mënyrë të vecantë të konsumatorëve që për rrethana ekonomike apo sociale janë në pamundësi për të kuptuar drejtë dhe për të marrë vendimet e duhura që lidhen me furnizimin e tyre me energji.

#### Plani jone i veprimit në këtë drejtim përfshin:

- ERE informon nëpërmjet të gjitha mjeteve që lehtësojnë komunikimin me konsumatorët me qëllim që ata të marrin pjesë në mënyrë efektive në treg.

- ERE mbështet dhe mbron konsumatorët e energjisë, për këtë ERE së pari përpunon informacionet që lidhen me konsumatorët në tregun e energjisë për të vijuar më tej me përgatitjen e informacioneve lehtësisht të kuptueshem të konsumatorëve të energjisë.

- ERE zhvillon pyetesorë me qëllim që të kuptojë drejtë mungesat në informacion apo natyrën e informacionit që konsumatorët kanë nevojë, apo sa besim kanë konsumatorët në shërbimet që atyre ju ofrohen dhe në informacionet që marrin.

Natyrisht jo e vetme ERE por edhe organizma të tjera që punojnë për të rritur mbrojtjen e konsumatorit, si përshembull Zyra e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Ministrisë së Fiancave, Agjencia për Eficiencën, Avokati i Popullit, organizmat, shoqatat e mbrojtjes së konsumatorit. ERE vlerëson me mjaft rëndësi bashkëpunimin me këto institucione për të vijuar punën e saj për të ofruar fushata informimi publik dhe edukim konsumator.

Po ashtu do të bashkëpunohet me furnizuesit për të siguruar politika informuese/ edukuese.

#### **Një tjetër dimension me mjaft rëndësi në mbrojtjen e konsumatorit është mbrojtja e konsumatorit edhe në këndvështrimin e diferencave gjinore.**

Në shumë kontekste, janë grupe që vuajnë më shumë nga kushtet e varfërisë ekstreme. Por edhe grupe të tjera janë ekspozuar në këto drejtim. Të tilla janë njerëzit e moshuar, fëmijët, njerëzit me aftësi të kufizuara, etj.

#### Plani i veprimit

Politika e ERE në mbrojtjen e konsumatorit do të marrë në konsideratë edhe promovimin e politikës me fokus grupe në përgatitjen e informacioneve të tilla si ato për përdorimin e energjisë, programet e vecanta për të përfituar nga skemat qeveritare apo dhe ato të shoqatave me fokus mbështetjen e konsumatorit. Të tilla janë promovimi i pjesëmarrjes në Komitetet e Energjisë.

Po ashtu në funksion të këtij objekti ERE do të zhvillojë Strategjinë e saj për mbrojtjen e Konsumatorëve.

Gjatë vitit 2023 me Urdhër të Kryeministrit të vendit është ngritur një grup pune për hartimin e kritereve për përfitimin e statusit të klienteve në nevojë dhe masave respektive për mbështetjen e tyre. ERE në vijim do të punojë për të reflektuar këto politike të qeverisë në strategjinë e saj të mbrojtjes së konsumatorit.

#### Plotesimi dhe rishikimi i kuadrit rregullator

Politika e mbrojtjes së konsumatorit është vazhdimisht në zhvillim për t'iu përgjigjur mjedisit të ndryshëm, nevojave dhe pritjeve të konsumatorëve.

### **Plani veprimit:**

ERE është gjithashtu e fokusuar në zhvillimin e kuadrit rregullator për të adresuar qasjen e duhur në çështjet që janë shumë të rëndësishme për konsumatorët në këtë treg dinamik të energjisë

Si rregullator, ERE gjithashtu do të angazhohet me të licencuarit për të perditesuar planet e masave për shërbimet e ofruara nga furnizuesit dhe respektimin e të drejtave të konsumatorëve nga furnizuesit në përputhje me zhvillimin e kuadrit rregullator.

**Pjesë e planit të veprimit** për mbrojtjen e konsumatorit do të jete edhe përgatitja e informacioneve ose përfshirë video mesazhe apo quizze për të kuptuar nivelin e tyre të informacionit për të drejtat e tyre për ndryshimin e furnizuesit apo pse është në të mirë të tyre të përdorin të drejtën e tyre për ndryshimin e furnizuesit. Në funksion të edukimit do të jete edhe promovimi i Platformes Pct të krahasimit të çmimeve.

ERE ka gjithashtu si pjesë të strukture organizative të saj një strukturë të dedikuar për trajtimin e ankesave të konsumatorëve dhe mosmarrëveshjeve midis operatorëve dhe konsumatorëve dhe është fokusuar në sigurimin e informacionit të qartë, për të informuar drejtë konsumatorët e energjisë për të drejtat e tyre.

Arritja e këtij objekti do të mbështetet kryesisht nga Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit si struktura që vendos kontaktin e parë me konsumatorin i cili zakonisht i drejtohet dhe njihet me ERE në momentin e një pakenaqesie ndaj furnizuesve.

Sa i takon edukimit të konsumatorit kjo do të jete një punë që do të përfshijë angazhimin e plotë të të gjitha niveleve vendimarrëse dhe drejtuese në ERE.

### **Përveç sa me sipër plani i veprimit të ERE për qëllime të fuqizimit të konsumatorit përfshin:**

Perditesimi i akteve rregullatore me praktikën me të mira rregullatore dhe me ndryshimet në legjislacionin primar. Pa përjashtuar mundësinë e rishikimit apo nxjerrjes së akteve të tjera ERE vlerëson si prioritarë rishikimin e akteve rregullatore si vijon:

- Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit;
- Rregullat për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- Rishikimi i rregullave të trajtimit të ankesave nga furnizuesit dhe planeve të masave të tyre.

Për këto puna do të konsistojë në zhvillimin e pyetësoreve me konsumatorët dhe me vetë furnizuesin lidhur me perceptimet e tyre ndaj këtyre rregullave.

Rishikimi do të konsistojë në përshkrimin e rregullimit në legjislacionin primar të sektorit por edhe atë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Për këtë ERE do të punojë ngushtësisht me të gjitha palët, institucionet shtetërore, shoqatat e konsumatorit dhe operatorët (të licensuarit) për të ndarë me ta nevojat për nderhyrjet e ndryshme në përmirësimin e këtyre rregullave për të pasur një qasje gjithnjë e më afër të zgjidhjeve jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve.

Fuqizimi i Konsumatorit do të konsistojë edhe në vendosjen e planeve të përbashkëta me shoqatat e konsumatorit dhe autoritetet lokale për promovimin e komuniteteve të energjisë dhe zhvilliminin e programeve edukuese për organizimin dhe pjesëmarrjen në këto komunitete.



Promovimi i sondazhit të vleresimit të kenaqesise së besueshemrise konsumatore, duke futur modele të standardizuara për marrjen e informacionit mbi nivelin e shërbimit të perceptuar nga konsumatori, do të jetë pjesë e standardeve të komunikimit me publikun.

Do të punohet për të kuptuar aksesin në shërbime digjitale nga konsumatori dhe për nevojën për promovimin e shërbimeve digjitale sa më të thjeshta.

Plani i veprimit do të përfshijë edhe promovimin e shërbimeve me fokus klientet me aftësi ndryshe për të mundësuar kështu akses të plotë dhe të njëjta për të gjithë konsumatorët.

### **Objektiva të ERE për mbrojtjen e konsumatorit**

**Tarifa të drejta:** Tarifa të bazuara në shërbime të realizuara me koston me të ulët dhe eficientë e të shpërndara në mënyrë të drejtë. Këto tarifa duhet të shmangin ndersubvencionet e të shmangin riskun e ekspozimit të konsumatorëve ndaj ngjarjeve të papritura.

**Standarde dhe cilësi shërbimi** - Shërbimet e klientëve gjatë zinxhirit të furnizimit me energji të jenë të qëndrueshme, transparente dhe të përgjegjshme. Konsumatorët duhet të mbrohen në funksion të një shërbimi me cilësi.

### **Plani i veprimit:**

Për këtë ERE do të kryejë një proces konsultimi mbi efektivitetin dhe nevojën për rishikim me të gjitha palët e interesit dhe në vlerësim të praktikave me të mira rregullatore dhe në përshtatje të mundësive dhe nevojave për investime.

Në konsulte me praktikantët me të mira dhe në kuadër të problematikave të hasura deri më tani, ERE do të rishikojë Metodologjitë respektive të përcaktimit të tarifave.

### **Fleksibilitet**

Konsumatorët kanë furnizim të sigurt dhe të qëndrueshëm. Kjo do të thotë që sektori tërheq investime të mjaftueshme afatgjata për të ofruar interesa të konsumit.

### **Plani i veprimit**

Përfshin vendimarrje të kujdesshme për investime që lidhen me sigurinë e furnizimit, dhe që fuqizojnë më tej rrjetin e që janë të hapur ndaj zhvillimeve teknologjike.

## **PER NJE TREG KONKURRUES PËRMES RREGULLIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT, ZBATIMI DHE PËRPUTHSHMËRIA.**

### **Objektiv 2- Liberalizimi**

"Paketa e pastër e energjisë" e vendos konsumatorin në qendër të tregut, nga njëra anë duke u bazuar në të drejtën e tij për zgjedhjen e lirë të furnizuesit, duke siguruar pjesëmarrje aktive të konsumatorëve. Aktualisht ERE ka miratuar rregullat për ndryshimin e furnizuesit. Zbatimi i këtyre rregullave në një kontrast që garanton tregun operacional është një nga prioritetet e ERE. Përveç zbatimit të detyrave të detyrimeve të caktuara nga ligji për aspektet që lidhen me tregun e brendshëm të energjisë elektrike, ERE duhet të monitorojë tregun e në mënyrë të vecantë zhvillimet e tregut të shitjes me pakicë, duke patur parasysh edhe politiken e qeverisë dhe

minisitrise pergjegjese per energjine ne lidhje me liberalizimin e tregut i cili ne janar te ketij viti, me daljen në treg të lirë të një numri jo te vogel konsumatoresh, rregjistroi në total 7358 konsumatorë që furnizohen në treg të lirë

### **Monitorimi**

Sic cituar me siper nje nga pergjegjesite e ERE eshte edhe monitorimi i te licensuarve ne tregun e energjise. ERE në zbatim të Ligjit 43/2015 “Per Sektorin e energjisë elektrke”, më konkretisht Neni 19, gërma k), publikon në faqen e internetit të dhëna katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike. Keto te dhena perpunohen edhe mbi baze vjetore dhe perfshijne:

- Te dhena mbi prodhimin neto vendas e te ndarw sipas kareorsie prodhim nga kompania publike apo burimet e tjera,
- Energji e siguruar per Furnizesin Universal, per Furnizuesin Publik, energji e siguruar per mbulimin e humbjeve,
- te dhena qe lidhen me Oshee Group (OSSH; FSHU, FTL) perfshire energji totale e hyre per Oshee, humbjet totale ne rrjet,
- Shitjet sipas kateogrive te konsumatoreve
- Arketimet
- Bilanci i Ost (prodhimi, eksport, import i relaizuar ne vend).

Gjithashtu ERE përgatit Raporte dhe të Dhëna të Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike Implementimi i REMIT aktualisht bazohet ne Kuadrin ligjor dhe praktikat me te mira nderkombetare te orientuar ne:

- Detyrimin për të publikuar informacione të brendshme
- Ndalimin e abuzimit të tregut (tregtimi i brendshem dhe manipulimi i tregut)
- Monitorimin e Tregut (regjistrimi i pjesëmarrësve në treg)

Mekanizmin e Raportimit te detajuar, mbledhja e të dhënave

- Kompetencat hetimore dhe të zbatimit të penaliteteve te rregullatorit
- Aspekte të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave
- Lista e kontratave dhe të dhënave që do të raportohen
- Palët përgjegjëse dhe afatet
- Udhëzime, rekomandime

Njohja e paleve me detyrimet e zbatimit te kesaj regulloreje

Bashkeveprimi nder rajonal per zbatimin e saj ne rajon e me gjere

Sikurses edhe me me siper politikat rregullatore edhe ne vijim do te kene per qellim qe të sigurojnë qëndrueshmëri ligjore dhe rregullatore per të menaxhuar potencialin për praktika abuzive që dëmtojnë ne menyre te padrejte tregun.

### **Plani i veprimit**

Aktualisht ERE ka miratuar Rregullat për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT), ne vijim te te miratimit te te cilave puna e ERE do te konsistoje ne monitorimin e zbatimit te ketyre rregullave.

Fokusi i punes se ERE edhe pergjate viteve 2024 - 2026 do te vijoje te jete perditesimali i Regjistrit Kombetar REMIT ne Shqiperi, i publikuar rregullisht edhe ne faqen e ERE sikurse publikimi e te dhenave mbi tregun e brendshem te energjise elektrike.

Por gjithashtu ERE do te monitoroje rregullisht transparencen ne sherbimet e operatorëve, jo vetem me qellim informimin e konsumatoreve, por edhe per te vleresuar zbatuesmerine e pergjegjesive te tyre ne raport me aktet rregullatore ne fuqi.

### **Konkurrenca**

Nje treg efektiv i emergjise ka ne themel konkurrencen. Eshte ne pergjegjesine e ERE qe vendimarrjet e saj, te promovojne konkurrencen. Si e tille kjo kerkese ligjore eshte nje objektivi i vazhdueshem i ERE.

### **Plani i Veprimit**

Per qellime te promovimit te konkurrences ne treg ERE synon te forcoje bashkepunimin me Autoritetin e Konkurrences per te ndare zgjidhjet me te mira per promovimin e konkurrences ne tregun e energjise.

Me qellim arritjen e objektivit per nje treg me pakice qe punon per konsumatorët ne synojme qasjen ndaj metodologjive qe sigurojne çmimet e drejta e qe promovojne konkurrencën dhe investimet inovative ne treg, investime ne perputhje me politikat mjedisore me vend si dhe politika qe marrin ne konsiderste promovimin e burimeve te rinovueshme si dhe mbrojtjen e konsumatoreve ne nevojë. Si te tille puna e ERE do te konsistoje ne nje rivleresim dhe konsulte me organizma te ndryshem nderkombetare per ndarjen e praktikave me te mira dhe te pershtatshme per sektorin e energjise elektrike ne vendin tone.

### **Objektivi 3**

#### **Të përdorim ekspertizën tonë për të informuar rreth zhvillimeve të tregut te energjisë dhe mbështesin tranzicionin e energjisë.**

Qellimi i ERE ne ushtrimin e detyrave te saj eshte nder te tjera te jete nje burim zyrtar dhe i besuar i informacionit rreth tregut të energjisë. ERE angazhohet në mënyrë efektive me palët e interesuara.

ERE kushton vemendje në ndjekjen ose promovimin e çështjeve prioritare në sektorin e energjisë.

#### **Plani i veprimit per realizimin e ketij objektivi perfshin:**

Studim i ceshtjeve me impakt ne tregun e energjise duke ofruar eksperiencen dhe ekspertizën tone ne kuader edhe te bashkepunimit dhe pjesemarrjes ne organizatat nderkombetare per te sjelle praktikate me te mira te rregullimit. Komunikimi permes te gjitha formave te komunikimit perفشire permes perdorimit te rrjeteve sociale per te terhequr vemendje per ceshtjet me interes te perbashket.

#### **Për të përmbushur nevojat e sistemit dhe mundësuar apo përshpejtuar investimet e nevojshme infrastruktura puna e ERE do te fokusohet ne:**

- bashkepunimin me operatorët e rrjetit të transmetimit dhe shperndarjes të energjisë elektrike në hartimin e planeve te zhvillimit te rrjetit dhe planeve te investimit kompanive të rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike

- Ndërmarrjen e iniciativave për rishikimin e akteve për lidhjen në rrjet dhe për përdorimin e tij.

Promovimi i teknologjive në shërbimet që ofrohen të tilla si programet për matës të inteligjentë por edhe të programeve të tjera që lidhen me fuqizimin e konsumatorit të tilla si Programi i Menaxhimit të të dhënave, apo programet e mbrotjes së të dhënave të konsumatorit.

Po ashtu në kauder të një dimensionit tjetër të ndryshëm nga ai klasik i operatoreve të rrjetit që lidhet me futjen e shërbimeve dixhitale por edhe me cenueshmerinë e tyre prej këtyre shërbimeve, ERE do të fokusohet në përmirësimin e Strategjisë së saj për Sigurinë Kibernetike në përputhje me ndryshimet në ligjin primar për sigurinë kibernetike.

### **Siguria kibernetike**

ERE dhe me heret ka konsideruar me mjaft rëndësi sigurinë kibernetike të infrastrukturave të rrjetit.

ERE ushtron funksionet rregullatore me qëllim promovimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera.

ERE konsideron sigurinë në hapësirën kibernetike si përgjegjësi e përbashkët me të licensuarit që operojnë në sektorin e energjisë elektrike për qëllime të furnizimit pa ndërprerje.

Për këtë qëllim ERE hartoi dhe miratoi rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike për të shmangur rreziqet e shkeljes apo dëmtimit të këtyre infrastrukturave në kuadër të operimit përmes platformave të ndryshme dixhitale.

### **Plani veprimit:**

Objektivi ynë është të vazhdojmë të mbrojmë konsumatorët duke ngritur vëmendjen në marrjen e masave për sigurinë e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë me fokus:

- Rishikimi i Rregullave në fuqi në bashkëpunim me operatorët e këtyre infrastrukturave dhe në konsultim me Akcesk si dhe në vlerësim të ndryshimeve në ligjin për Sigurinë e Infrastrukturave Kritike.
- Mbikëqyrja e vazhdueshme e zbatimit të planeve të masave nga operatorët e infrastrukturave kritike për mbrojtjen nga incidentet dhe sigurinë kibernetike për të shmangur ekspozimin e konsumatoreve
- Digitalizimi - Mbeshtetje e operatoreve të infrastrukturave kritike në implementimin e standardeve që lidhen me sigurinë kibernetike.

### **4- Objektiva të tjera**

#### **Zhvillimi i Burimeve të Rinovueshme**

ERE për qëllime të promovimit të burimeve të rinovueshme ushtron funksionet e saj bazuar në ligjin nr. 24/2023 *“Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”*; Veprimtaria e ERE përfshin si të tilla referuar edhe rekomandimeve në rezolutën respektive të Kuvendit, për promovimin e programeve për zhvillimin e burimeve të rinovueshme, eficienten e energjisë

### **Plani i veprimit**

Politikat e promovimit të Burimeve të Rinovueshme - ERE do të vijoje punën për miratimin e akteve rregullatore të përcaktuara në ligjin për burimet e rinovueshme.

Në kuptim të ligjit ERE është autoriteti përgjegjës për lëshimin e garancive të origjinës. Në zbatim të nenit 22, pika 2 e këtij ligji përcaktohet se ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.

Po ashtu, në nenin 22, pika 14 e këtij ligji është parashikuar se *ERE duhet t'i bashkohet sistemi rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë.*

Ky detyrim është përmbushur nga ERE me nënshkrimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

Në nenin 22, pika 1, të këtij ligji përcaktohet, ndër të tjera, se *ERE-ja miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.* Në zbatim të këtij përcaktimi është draftuar Rregullorja për lëshimin, transferimin, tërheqjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme.

Në hartimin e kësaj rregulloreje janë marrë në konsideratë përcaktimet e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, specifikat e sistemit rajonal të garancive të origjinës dhe elementet e regjistrit elektronik të GO-ve. Në vijim ERE do të punojë për finalizimin e këtij procesi për miratimin e ketyre rregullave dhe implementimin e marrëveshjes për regjistrin elektronik të sistemit rajonal të garancisë së origjinës.

Digjitalizimi: - Puna e ERE do të konsistoje në bashkëpunim me operatorët, për të përshpejtuar proceset e digjitalizimit që lehtësojnë aksesin e përdoruesve dhe konsumatorëve ndaj shërbimeve që operatorët ofrojnë.

## **Kapitulli IV**

### **Përfundime**

Sfidat e tregut të energjisë, ndryshimet në legjislativën primare dhe atë sekondare, si dhe në ndryshimet teknologjike, me të cilat ballafaqohen konsumatorët e energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut në teresi sjellin në fokus të punës të ERE, adresimin e çështjeve që kërkojnë ndërhyrjen e rregullatorit. Për këtë qëllim ERE ka përcaktuar në këtë dokument objektivat strategjike për të patur një vizion të qartë të çështjeve prioritare dhe planit të veprimeve.

ERE do të vijoje të kryejë analiza/studime të aspekteve të rëndësishme të kuadrit rregullator që kanë të bëjnë me çështjen e shërbimeve të rregulluara.

ERE do të shqyrtojë kuadrin rregullator të nevojshëm për fuqizimin e Konsumatorëve dhe mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë;

Vendosja e cmimeve të drejta dhe të arsyeshme është një nga prioritetet kryesore e për këtë qëllim ERE do të rishikojë metodologjitë respektive të përcaktimit të tarifave të transmetimit, shpërndarjes dhe cmimeve të rregulluara.

ERE do të përditësojë Rregullat e saj mbi sigurinë kibernetike si dhe do të monitorojë zhvillimet e planeve të zbatimit të sigurisë kibernetike gjithashtu nga këta operatorë.

Prioritet në punën e ERE vijon të jetë mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorit, dhe nxitja e konkurrencës në treg, përcaktimin e tarifave dhe cmimeve të drejta, mbështetjen e operatorëve në investimet për sigurinë e furnizimit me energji elektrike, monitorimin e shërbimeve të të

licensuarve ne pergjithesi dhe ne permbushjen e standarteve te cilesise se sherbimit, dhe plotesimin e kuadrit rregullator te nevojshem apo dhe rishikimin e tij.

ERE do të vijojë te promovojë, dhe bëjë përpjekjet më të mira për të përfshirë paët e interesit në vendimmarrje, per te percuar besimin tone në vlera te tilla si integriteti, thjeshtësia, gjithëpërfshirja, dhe mbi te gjitha besimi dhe respekti i ndërsjellë.

Këto vlera perbejnë Kulturen tone te punes, nje kulture ku të gjithë kanë përgjegjësi për të vepruar për interesin afatgjatë të shoqërisë.